



AVOKAT – LAWYER  
**Besnik R. BERISHA**

Rr / Str. Luan Haradinaj 21/2, 10000 Prishtinë  
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
E- mail: [besnik.berisha@yahoo.com](mailto:besnik.berisha@yahoo.com)  
Tel & Fax: +381 (0) 38 220 562  
Mobil: +377 (0) 44 151 402

PP. I. nr. 58/23

**DREJTUAR:** z. Shukri JASHARI,  
Kryeprokuror pranë Prokurorisë Themelore  
në Ferizaj

**PËR DIJENI:** z. Besim KELMENDI,  
UD i Kryeprokurorit të Shtetit  
  
z. Sahit KRASNIQI,  
Gjyqtar i procedurës paraprake

**OBJEKTI:** Kërkesë për kthimin e telefonit të ndaluar, në  
pronësi të zyrës së avokatisë

**BAZA LIGJORE:** Kodi Nr. 08/L-032 për Procedurën Penale,  
neni 113

Të nderuar,

- Në cilësinë e qytetarit të Republikës së Kosovës, viktimi e një procesi hetimor të montuar, një arrestimi arbitrar dhe të kundërligjshëm, si dhe të kimeve të bëra nga prokurori Rasim Maloku, prokuror pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të denoncuara publikisht, si dhe me kërkesën e datës 20.07.2023, duke vepruar në mbrojtje të së drejtës për privatësi, të garantuar me nenin 36.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe mbështetur në nenin 113 të Kodit Nr. 08/L-032 për Procedurën Penale dhe nenin 20.1 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, me respekt ju drejtohem me këtë kërkesë për kthimin e telefonit në pronësi dhe menaxhim të zyrës së avokatisë, të sekuestruar më datë 13.07.2023, sepse nuk ekziston baza ligjore për sekuestrimin e tij të përkohshëm.

2. Ndonëse jam i vetëdijshëm se ju nuk jeni adresa e duhur për të paraqitur këtë kërkesë, por për arsyet tashmë të njohura, meqenëse procesi hetimor kundër meje është i motivuar personalisht dhe politikisht, ndërsa tashmë komunikimi me prokurorin Rasim Maloku është objektivisht i pamundur, për shkak të urrejtjes dhe hakmarrjes që ky i fundit ushqen dhe synon kundër meje, si pasojë e denoncimit publik të kimeve të kryera nga i njëjti, jam i shtyrë që këtë kërkesë ta parashtroj përpara jush për të mbrojtur konfidencialitetin dhe fshehtësinë e relacionit avokat-klient.
3. Përpara elaborimit të arsyeve që mbështesin kërkesën, ju siguroj se qëllimi i të njëjtës nuk është pengimi i hetimit, apo fshehja e përbajtjes së materialeve që gjenden në telefonin e avokatisë, në pronësi dhe administrim të zyrës së avokatisë, sepse nuk kam asgjë për të fshehur, por kam obligim ligjor dhe etik ruajtjen e konfidencialitetit të komunikimeve avokat-klient, e cila garantohet me Kushtetutë dhe dispozitat procedurale të KPPRK.
4. Ndërkohë, ju shpreh gatishmérinë time për një ekzaminim publik të pajisjes në prani të mediave dhe të një prokurori të paanshëm, të pavarur dhe objektiv.
5. Ashtu siç tashmë jeni informuar përmes kërkesës së datës 20.07.2023, më datë 13.07.2023, unë arbitrarisht dhe kundërligjshëm jam privuar nga liria, si rrjedhojë e kimeve të kryera nga prokurori Rasim Maloku, tashmë të denoncuara publikisht, bazuar në trillimet, manipulimet me prova, falsifikimet, gjenjeshtrat dhe mashtrimet e kryera nga i njëjti, mbi bazën e të cilave prokurori Rasim Maloku fabrikoi dyshimin e bazuar se unë kinse kam kryer veprat penale *Ushtrimi i ndikimit*, të sankzionuar nga neni 424 i KPRK, *Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale*, të sankzionuar nga neni 380 i KPRK dhe *Pengimi i të provuarit, apo procedurës zyrtare*, të sankzionuar nga neni 386.1, nënpas. 1.3 i KPRK.
6. Krimet e kryera nga prokurori Rasim Maloku, tashmë të denoncuara publikisht dhe zyrtarisht, rrëzojnë bazën ligjore për sekuestrim të pajisjes, përkatësisht ekzistimin e gjasave reale që unë të kem kryer veprat penale të trilluara dhe të fabrikuara nga prokurori Rasim Maloku, si kusht *sine qua non* për sekuestrimin e pajisjes.
7. Për më tepër, telefoni i sekuestruar, në pronësi të zyrës së avokatisë, nuk përbën as mjet të kryerjes së veprës penale dhe as produkt që derivon nga kryerja e veprës penale.
8. Më tej, marrë parasysh faktin se dyshimet ndërlidhen me vepra në kuadër të ushtrimit të profesionit dhe se profesioni i avokatit përbën kategori kushtetuese, të rregulluar me nenin 111 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, **telefoni i zyrës së avokatisë përbën send që nuk mund të sekuestrohet përkohësisht, konform ndalesës nga neni 111 i KPPRK**, sepse materialet dhe komunikimet me klientë, që gjenden në pajisjen në fjalë, të sekuestruar në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrale, datojnë që nga **05.10.2010**, kur unë kam filluar punën si avokat.
9. Për pasojë, pajisja assesi nuk duhet të ishte objekt i kontrollit dhe aq më pak i sekuestrit, apo ndalimit.

10. Telefoni i avokatisë, që në rastin konkret është në pronësi dhe administrim të zyrës së avokatisë përdoret edhe si arkiv elektronik/kompjuter zyre i të gjitha lëndëve, përmban të dhëna konfidenciale mbi punën time gati 13 vjeçare si avokat, përkatesisht në pajisjen në fjalë gjenden të dhëna sensitive, dokumente dhe komunikime mbi strategjinë e mbrojtjes dhe përfaqësimit të klientëve të avokatisë në procedura të ndryshme penale, për të cilat ekziston dhe garantohet fshehtësia e korrespondencës dhe komunikimeve, të garantuara me nenin 61.2 të KPPRK.
11. Marrja dhe mbajtja e kundërligjshme e telefonit të avokatisë përbën një *vulnus* për të drejtën për privatësi, që derivon nga relacioni avokat-klient, të të gjithë klientëve të kaluar dhe aktualë që unë dhe zyra ime e avokatisë kemi mbrojtur dhe mbrojmë në procedura penale të ndryshme.
12. Për më tepër, marrë parasysh faktin se aktvendimi për fillimin e hetimeve iu dorëzua GJPP vetëm më datë 12.07.2023, kjo me automatizëm shpie në konkludimin se të gjitha bisedat dhe komunikimet e bëra përpëra asaj date nuk mund të jetë subjekt i nxjerrjes dhe përdorimit të tyre në mënyrë retroaktive, siç është vendosur me standardet e përcaktuara me aktgjykin e Gjykatës Supreme Pml.nr.29/2021, dt. 13.04.2021 dhe aktgjykin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. ref: AGJ 1932/22, dt. 05.01.2022, në rastin nr. KI113/21.
13. E fundit, por jo për nga rëndësia, prej 8 ditësh unë dhe zyra e avokatisë kemi shkëputur lidhjet me të gjithë klientët e shumtë brenda dhe jashtë vendit, të cilët gjenden në pasiguri totale juridike, sepse as nuk mund të komunikojnë lirshëm me avokatin e tyre dhe as nuk ndihen të sigurtë nga korrespondanca paraprake e tyre me zyrën e avokatisë dhe provat e dërguara e të ruajtura në këtë pajisje të zyrës së avokatisë.
14. Përveç tjerash, kjo situatë pengon kundërligjshëm në ushtrimin e profesionit, si dhe në përbushjen e detyrimeve ligjore dhe etike karshi të gjithë klientëve të zyrës së avokatisë.
15. Në mbyllje të parashtrimeve nga kjo kërkesë, për aq sa lejon ligji dhe praktika e konsoliduar gjyqësore, me qëllim të zvogëlimit të dëmeve, përsëris ftesën për ekzaminim publik të pajisjes në prani të mediave dhe të një prokurori të paanshëm, të pavarur dhe objektiv, në afat sa më shkurtër kohor.

**Petitumi:**

Për arsyet e lartpërmendura, marrë parasysh faktin se tashmë është provuar haptazi urrejtja e prokurorit Rasim Maloku kundër meje dhe se e njëjta është aq e thellë, e motivuar dhe aq e theksuar, saqë çdo vendim dhe veprim që i njëjti mund të ndërmarrë nuk do të jetë objektiv dhe i pavarur, marrë parasysh natyrën serioze dhe të rëndë të krimeve të denoncuara publikisht, si dhe zyrtarisht me kërkesën e datës 20.07.2023, me qëllim të garantimit efektiv të së drejtës për privatësi, veçanërisht të ruajtjes së konfidencialitetit në relacionin avokat-klient, me respekt kërkoi nga ju që:

- TË URDHËRONI kthimin e telefonit në pronësi dhe administrim të zyrës së avokatisë, sekuestrimi i të cilit kundërligjshëm dhe arbitrarisht është kërkuar nga prokurori Rasim Maloku, pajisje e cila edhe më tutje mbahet në objektet e policisë pa shkak dhe bazë ligjore, sepse nuk ka bazë ligjore për sekuestrimin e përkohshëm, apo konfiskimin e tij.

Me respekt e parashtruar nga,



Av. Besnik R. BERISHA

Prishtinë, më 21 korrik 2023